

Qyteti im

falas

Edicioni i Verës



**Projekti i Qendrës së Korçës i besohet arkitektëve gjermanë
8 skulptura të reja i shtohen Parkut "Rinia" të qytetit
Korça, qendra e festimeve verore në Shqipëri**



KORÇA KU

DUA TE JETOJ

KONKURS NDËRKOMBËTAR PËR QENDRËN E QYTETIT

“Bolles & Wilson” shpallet studioja fituese

Nëpërmjet organizimit të këtij konkursi, Bashkia do të realizojë transformimin bashkëkohor të qendrës së qytetit, mbështetur edhe në elementët dhe vlerat tradicionale

Përfundoi me sukses të plotë projekti i Bashkisë së Korçës për Studimin e Qendrës së Qytetit, në përfundim të të cilit u shpall fituese, studioja gjermane Bolles & Wilson.

Katër Studiot e përzgjedhura për në fazën finale ishin pikërisht: 51N4E (Bruksel-Belgjikë); Bolles & Wilson (Munster-Gjermani); Domus Architecture (Portugali); Joubert Architecture (Rotterdam-Hollandë).

Në përfundim të katër prezantimeve publike dhe një diskutimi të thellë mes anëtarëve të jurisë lidhur me vlerat e sejcilit propozim konkurues, në përgjigje të nevojave të qytetit të Korçës, mbi bazën e kriterëve të vlerësimit të përcaktuara në detyrën e projektimit, juria vendosi njëzëri të vleresojë me Çmimin e Parë të konkursit, Studion Bolles & Wilson dhe me Çmimin e Dytë, Studion Joubert Architecture.

Veç votimit të jurisë, projektet e paraqitura iu nënshtruan edhe votimit të publikut ku interesante ishte përputhja e rezultatit. Të gjitha projektet synonin krijimin e hapësirave për kalimtarët, me idenë bazë që qyteti duhet t’u “kthehet” qytetarëve të tij.

Nëpërmjet organizimit të këtij konkursi, Bashkia do të realizojë transformimin bashkëkohor të qendrës së qytetit, mbështetur edhe në elementët dhe vlerat tradicionale.



Juria ndërkombëtare, një panel me të ftuar nga fusha e arkitektures, urbanistikës, intelektualë të fushave të ndryshme etj, e përbërë pikërisht nga nga Z. Jaime Carne -Spanje, Z. Niko Peleshi -Kryetari i Bashkisë Korçë, Z. Ben Blushi -Tiranë, Z. Martino Tattara -Itali, Z. Arben Biçoku -Tiranë, Z. Altin Gagani -Tiranë, Z. Aleks Papakozma -Korçë, e asistuar nga Z. Sotiraq Filo, Znj. Edvana Vangjeli dhe Znj. Adelina Greca, gjykoi ndër katër studimet e realizuara dhe të prezantuara nga këto studio ditën e mërkurë, në datën 15 korrik në sallën e konferencave të Grand Hotel Palace ora 9.30.

TË PËRBASHKËTAT DHE TË VECANTAT

e studiove ndërkombëtare që garuan për

MASTERPLANIN E QENDRËS SË KORÇËS

Çfarë i bashkoi

Juria ndërkombëtare dhe publiku që i ndoqi nga afër me shumë interes propozimet e 4 studiove për qendrën e Korçës i vlerësoi me nota të larta propozimet që ardhën nga studiot konkurrenente. E përbashkëta e tyre ishte fakti që ato propozuan më shumë zona të gjelbra dhe hapësira publike duke ruajtur nga njëra anë arkitekturën ekzistuese të godinave të qendrës dhe duke propozuar njëkohësisht ndërtime moderne dhe mjaft komplekse me funksion ekonomik si dhe hapësira publike shlodhëse e argëtuese.



Të veçantat

"Bolles & Wilson" Gjermani -projekti fitues

Studioja propozon një bllok ndërtimi miks me vila të vjetra të stilit karakteristik urban të Korçës, me një lartësi trekatëshe dhe me ndërtesa të reja që e kalojnë këtë lartësi. Ai parashikon zgjerimin e sheshit para Katedrales së qytetit, duke përfshirë në të aktivitetet të shumta tregëtare, por edhe kulturore e argëtuese nëpërmjet vendosjes së dy ekranëve të mëdhenj në të dy krahët e Katedrales. Për zonën këmbësore përgjatë Bul. Shën Gjergjit si dhe për Lulishten "V.Mio" parashikohet një rritje e sipërfaqes së gjelbëruar dhe më tej, një kompleks tregëtar në formë piramide tek sheshi në krah të Teatrit "Andon Z. Çajupi".

Ajo propozon rivitalizim të Lulishtes "V.Mio" nëpërmjet ngritjes së disa lokaleve dhe një pasqyrë ujore mbrapa Shtëpisë Rumune.

Studioja holandeze e projektimit "Joubert Architecture" u cilësua si projekti më kreativ dhe më modern. Projektuesit propozuan një pasqyrë uji në formën e një liqeni artificial mbi të cilin ngrihet një qendër tregëtare.

Studioja belge 51N4E, propozon një shkëmbim vendesh mes shesheve dhe sipërfaqeve të gjelbra. Ajo parashikon gjelbërimin total të sheshit para katedrales, ndërsa Lulishten "Vangjush Mio" e kthen në një shëtitore.

Studioja portugeze "Domus Concept" ishte propozimi më radikal për qendrën e qytetit. Krahas të tjerave, ai ishte konceptuar me 7 ndërtime në formë trekëndore me mbulesë të valëzuar për sejcilën prej ngrehinave dhe me gjelbërim në brendësi të tyre.

Vazhdojnë me intensitet investimet në të gjithë qytetin

Lagjia 10

Investimi kompleks për sistemimin mes blloqeve të pallateve

Lagjia 10 e qytetit të Korçës, pavarësisht se është një lagje qendrore, vetëm gjatë dy viteve të fundit ka filluar të marrë pamje të urbanizuar.

Pas sistemimit dhe asfaltimit të rrugës në dritat e verdha dhe kthimit në identitet të lulishtes në krah të saj, po punohet në brendësi, në rrugët dhe sheshet mes pallateve. Është një ndërhyrje komplekse, e cila filloi me kanalizimin e ujrave të përdorura nga Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe po vazhdon me sistemimin e zonës për të ecur më tej me asfaltimin, ndërtimin e trotuareve dhe krijimin e ishujve të gjelbër mes pallateve, duke krijuar një ambient komod e çlodhës për banorët e këtij blloku.



Investimi në Lagjen 6 Punohet në dy fronte

Investimi në Lagjen 6 të qytetit është drejt përfundimit.

Kryetari i Bashkisë Niko Peleshi ka parë nga afër ecurinë e punimeve në këtë lagje dhe ka vlerësuar së ky investim, i fituar nga Bashkia e Korçës nga Grandet Konkurruese të qeverisë shqiptare, po zhvillohet normalisht.

Pas përfundimit të kanalizimit dhe shtresës së sipërme, do të fillojë asfaltimi i rrugicave të kësaj lagje periferike të qytetit. Investimi, krahas sistemim-asfaltimit dhe ndërtimit të trotuareve, parashikon edhe gjelbërimin e asaj pjese të Unazës që rrethon këtë bllokbanimi.

Një tjetër investim në Lagjen 6 është drejt përfundimit.

Me një fond prej 4 milion lekësh nga të ardhurat e Bashkisë Korçë që i ka hapur rrugë investimit në pjesën fundore të Rrugës "28-Nëntori", ka përfunduar asfaltimi në bllokun e pallateve si dhe janë vendosur bordurat për lulishten e re. Po punohet për ta kompletuar këtë zonë edhe me elemente të tjerë të infrastrukturës, siç janë gjelbërimi dhe një kënd lojrash për fëmijët. Me këtë investim, Bashkia Korçë i përgjigjet kërkesës së banorëve të kësaj zone për mjedise çlodhëse dhe kënd lojrash.



Filozofia jonë: INVESTIME NË BLOQE BANIMI



Infrastruktura e Lagjes 13 me një fytyrë të re

Lulishte dhe kënd lojrash për fëmijët e Lagjes 13 të qytetit, ishte investimi më i fundit i Bashkisë Korçë me ndihmën e UNICEF. Investimi mjaft kompleks, i shtrirë në një sipërfaqe të konsiderueshme mes pallatesh, ia ndryshoi pamjen këtij bllokbanimi. Në të u ndërtuan disa minilulishte, të cilat u gjelbëruan duke u mbjellë me bar dhe shkurre dekorative si dhe u ngrit një kënd lojrash dhe kalçeto për fëmijët.

Në fjalën e rastit, Kryebashkiaku Peleshi u premtoi banorëve të këtij blloku dhe veçanërisht fëmijëve, se do të angazhohet për të ngritur një kënd lojrash në ç'do lagje të qytetit.

Investim në bllokun pranë Xhamisë "Iliaz B. Mirahori"

Me fondin prej 300 milion lekësh nga Grandet Konkurruese të qeverisë shqiptare, janë duke u sistemuar rrugicat dhe sheshi përreth Xhamisë "Iliaz Bej Mirahori".

Në fund të gushtit përfundoi asfaltimi i Rrugës "Bajram Curri", një nga arteriet më të rëndësishme të kësaj zone. Investimi merr parasysh dhe e trajton Xhaminë "Iliaz B.Mirahori" si objekt qëndror në këtë investim për shkak të vlerave historike dhe kulturore që ajo mbart. Kështu përreth këtij objekti që është monument kulture, shtrimi i rrugës do të bëhet me kalldrëm, ndërsa të gjitha rrugët e tjera do të asfaltohen. Investimi përfshin edhe krijimin e sistemit të ndriçimit të kësaj zone.

PËRFUNDON

sistemimi në Lagjen 18

Së shpejti zona do të gjelbërohet

Ende pa përfunduar puna, blloku mes pallateve, në Lagjen 18 të qytetit ka ndryshuar pamje. Pas përfundimit të sistemit të kanalizimeve nga Ndërmarrja e Ujësjellësit –Kanalizimeve të qytetit, me një fond prej 50 milion lekësh të fituara nga Bashkia Korçë nga Grandet Konkruuese të qeverisë shqiptare, ka përfunduar sistemimi dhe asfaltimi i të gjitha rrugëve mes pallateve dhe janë ndërtuar e sistemuar njëkohësisht trotuaret. Në këtë bllok pallatesh, Bashkia Korçë, nëpërmjet Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, shumë shpejt do të fillojë gjelbërimin e mjaft sipërfaqeve, të cilat janë parashikuar për lulishte e ambiente çlodhëse.

Në fund të muajit gusht, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, me të ardhurat e veta filloi sistemimin e një tjetër bllokbanimi në Lagjen 18, poshtë Shkollës "Raqi Qirinxhi". Po punohet duke vendosur bordurat për krijimin e lulishteve në këtë zonë.



PUNOHET

për rikonstrukcionin e aneksit të stadiumit

Investimi i Bashkisë Korçë prej 8 milion lekësh do të transformojë pamjen e abandonuar të aneksit të Stadiumit të qytetit të Korçës. Në një sipërfaqe prej 10 mijë m², është duke u ngritur fusha e përmasave olimpike, në të cilën do të stërviten të gjitha ekipet e futbollit të skuadrës korçare. Me fondin e Bashkisë Korçë po kryen të gjitha përgatitjet e fushës për tapetin e barit, siç janë germim, drenazhim, ngjeshje dhe rrethimi i fushës. Pas kësaj, sipas kontratës mes Bashkisë Korçë dhe Federatës Shqiptare të Futbollit, do të bëhet shtrimi i tapetit të gjelbër.

Bulevard "Republika" RIKONSTRUKSION *total*

Rikonstrukcioni i Bulevard "Republika" është një nga investimet më të mëdha dhe më të rëndësishme që Bashkia e qytetit do të zbatojë për vitin 2009.

Pas hapjes së pusetave të ujrave të përdorura, nga Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve të qytetit me fondin e koston lokale të kanalizimeve, do të fillojë menjëherë investimi i Bashkisë me vlerën



83 milion lekë nga të ardhurat e veta, për shtrimin me pllaka guri të bulevardit dhe trotuareve përgjatë tij, duke përmirësuar ndjeshëm pamjen e kësaj shëtitoreje mjaft të frekuentuar nga qytetarët. Pas sistemimit, investimi do të kalojë në një fazë të dytë që është rikonstrukcioni i fasadave të 12 godinave përfaqësuese të arkitekturës karakteristike korçare, me vlerën 23 milion lekë të cilat do të shoqërohen edhe me ndriçim dekorativ për në mbrëmje.

Në total ky investim kap vlerën 106 milion lekë, i cili do të përballohet tërësisht nga të ardhurat e Bashkisë Korçë.

ZGJEROHET HARTA e rrugicave me kalldrëm *në lagjet karakteristike të qytetit*



Rrugicat karakteristike në lagjet e vjetra të qytetit do të ruajnë identitetin e tyre, pasi ato janë pjesë historike e trashëgimisë kulturore të Korçës.

Pas kompletimit të Lagjes 12 me kalldrëmin e ri, me gurët në formë katrore, të cilat kanë hijeshuar mjaft pamjen e rrugicave në këtë lagje, duke lehtësuar njëkohësisht lëvizjen e këmbësorëve ashtu edhe të automjeteve, puna ka filluar gjatë muajit korrik në shtrimin e këtij tapeti në mjaft prej rrugëve në Lagjen 1 të qytetit. Puna përfundoi në muajin gusht në tre prej tyre, pikërisht në rrugët "Ramiz Arianitasi", "Fuat Babani" e "Lidhja e Prizërenit". Puna ka filluar në tre rrugë të tjera të kësaj lagjeje "Jani Dudo", "Jorgo Plaku" e "Papallambro Ballamaçi", të cilat parashikohet të përfundojnë gjatë muajit shtator.



Foto nga Devis Tytka

“FESTIVALI NDËRKOMBËTAR I KARNVALEVE”

Më 6 Qershor, në qendër të qytetit të Korçës u zhvillua Festivali Ndërkombëtar i Karnavaleve, evenimenti më i rëndësishëm që organizohet për të dytën vit nga Bashkia e qytetit. Me këtë festë Bashkia e Korçës, shpalli çeljen sezonin turistik për vitin 2009, duke i paraprirë festave të shumta që organizohen gjatë sezonit veror.

Aktiviteti i përmasave të mëdha, i vetmi i këtij lloji në Shqipëri, gjallëroi në orët e mbrëmjes qytetin e Korçës, në të cilin u përfshinë mjaft fëmijë të veshur me petkun e karnavalit. Për veshjet dhe aksesoret e kësaj feste Bashkia u kujdes në mënyrë të veçantë duke bashkëpunuar me biznesin.



NE KORÇËN E FESTAVE

30 grupe karnavalesh nga Shqipëria, Maqedonia e Mali i Zi me mbi 700 pjesëmarrës, performuan me fabulat e tyre në sheshin kryesor të qytetit para Katedrales, për të vazhduar më tej parakalimin në rrugët dhe bulevardet kryesore të qytetit të Korçës, duke rikthyer nurin e dikurshëm të Karnavaleve të Korçës, festës popullore të identifikuar me emrin e qytetit. Nuk munguan në këtë festë, serenatistët me kitara në dorë, grupi i polenës me këmborët që gumëzhinin, këmbajkat, cirku i Tiranës me fëmijët akrobatë, plaku prej bore dhe babagjyshet e vegjël, maskat butaforike me koka kafshësh e njerëzish, grupet e minoritetit maqedonas, rom dhe grupi nga Prilepi i Maqedonisë me veshjet, ritet dhe ritmet muzikore që i karakterizojnë.

Grupet e karnavaleve, spikatën për shumëllojshmërinë e fabulave dhe të mesazhit që ato përcollën, të cilat u përzgjedhën me shumë kujdes nga stafi organizator. Impresionuese ishte edhe pjesëmarrja e trupës profesioniste të Teatrit të Korçës, të cilët ishin në krah të trupave të tjera pjesëmarrëse.

Rikthimi i kësaj feste popullore u mirëprit nga banorët e qytetit tonë, por njëkohësisht ajo tërhoqi vëmendjen e turistëve vendas dhe të huaj, duke rifituar statusin e festës simbol të qytetit.

Karnavalet e Korçës, janë pjesë e filozofisë së Bashkisë Korçë, për t'i dhënë qytetit një profil të veçantë, profilin "Korça, qyteti i festave".

FESTA E BIRRËS...



Katër netët e Festës së Birrës në Korçë, 13-16 gusht 2009, të pushtuara na entuziazmi i qindra e mijëra njerëzve, korçarëve e të ardhurve nga rrethet e tjera si dhe mjaft turistëve të huaj, me birrën e freskët që u derdh lumë, me prodhimet e shkëlqyera të sallamerive të rajonit dhe kërnacet e traditës dhe me ritmet më të njohura të këngëve nga grupet më të njohura muzikore brenda e jashtë vendit, do të mbahen mend gjatë nga të gjithë.

Sheshi i festës u pushtua nga entuziazmi i të rinjve por edhe i familjarëve, të cilët në shoqërinë e njëri-tjetrit kaluan disa orë të gëzuara e çlodhëse, larg problemeve e monotonisë së përditshme. E veçanta e këtij viti ishte një kënd i veçantë lojrash për fëmijët, të cilët nën kujdesin e animatorëve u argëtuan përmes lojrave të shumta duke lehtësuar kështu edhe prindërit e tyre për të kaluan disa orë në festë, në freskinë dhe shijen e birrës.

Vetëm në Korçë

*F*esta e berrës edhe për këtë vit shënoi kulmin e sezonit turistik. E reja e këtij viti dhe më e rëndësishmja, ishte numri i madh i vizitorëve nga rrethet e tjera por edhe turistët e huaj. Indikator i këtij fakti ishte plotësimi i të gjithë kapacitetit të hoteleve gjë që tregon se jehona e kësaj feste i kapërceu kufijtë e qytetit, duke kapërcyer njëkohësisht edhe vështirësitë e krizës globale. Në katër netët e festës u konsumuan 112 mijë gota berrë krahas dhjetra shisheve të tjera, të cilat plotësuan kërkesat në rritje të pjesëmarrësve.

Bazuar në këto shifra si edhe në opinionet e ardhurve nga jashtë qytetit, Festa e Berrës në Korçë është festa më e madhe dhe më popullore në Shqipëri në sezonin veror.



*F*esta njëkohësisht po çon në rritjen e interesit të sektorit privat hoteleri dhe shërbime duke i bërë ato më pretenduese për të rritur cilësinë e shërbimeve.

Padyshim që kjo festë është edhe një promovim i vlerave qytetare të Korçës sonë. Korçari e ka në gen argëtimin e qefin. Kjo festë masive vazhdoi për katër net, duke mos shënuar asnjë incident.

Festa e Berrës i ka kushtuar Bashkisë Korçë vetëm 600 mijë lekë pasi e gjithë pjesa tjetër u përballua nga pjesëmarrësit, fabrikat e berrës dhe ato të sallamerive si dhe punishtet e prodhimit të ëmbëlsirave. Një ndihmë të madhe dhanë edhe sponsorat.

*N*ë përpjekjet dhe programet e Bashkisë së qytetit për t'i dhënë Korçës një profil të ri, atë të "Korça qyteti i festave" si dhe për ta bërë qytetin një destinacion për turizmin e fundjavës, Festa e Berrës padiskutim që ka dhënë dhe do të japë edhe në vitet në vazhdim, kontributin më të madh në ndërtimin e kësaj rruge

Festa e lakrorit

në rrugën e traditës



“Festa e lakrorit” u quajt me të drejtë gatimi i lakrorit në saç, i aplikuar për herë të parë nga Bashkia e Korçës vitin e kaluar në Parkun “Rinia” të qytetit, me një projekt, i cili menjëherë gjeti mbështetjen e qytetarëve. Pas suksesit të një viti më parë ajo u rikthye gjatë këtij viti, akoma edhe më e bukur, me një pjesëmarrje më të lartë të amvisave gra, por edhe e vajzave të reja, ku nuk munguan dhalla e freskët e “Greal” dhe ëmbëlsirat e “Dajanës”.

***Festa** merr ngjyra edhe nga turistët vendas e të huaj*



Festa gjallëroi në një pjesëmarrje mjaft e lartë qytetare ku nuk munguan edhe turistët nga Franca, Gjermania, Amerika e vende të tjera, të cilët kanë parë mënyrën e gatimit të lakrorit në saç e më pas e kanë shijuar atë.

Këtë traditë të rajonit tonë, Bashkia e Korçës e ka kthyer në një festë masive, duke synuar në këtë mënyrë jo vetëm ruajtjen e kësaj veçantie të kulinarisë sonë, e cila është mjaft e kërkuar nga të gjithë, por edhe tërheqjen e turistëve duke promovuar resurset që mbart rajoni i Korçës.

Skulptura të reja pasurojnë

GALERINË E ARTIT MODERN

në Parkun "Rinia" të qytetit



Në datat 25 qershor deri 6 korrik 2009, në qytetin e Korçës u zhvillua me sukses edicioni i dytë ndërkombëtar "Skulptura e Parkut - Korça 2009".

Artistë të ardhur nga e gjithë bota, me një shtrirje gjeografike mjaft të madhe, Gjermania, Italia, Japonia, Egjipti, Britania e Madhe dhe Zelanda e Re, përgjatë dy javëve realizuan veprat e tyre në natyrë, tek Parku "Rinia". Projektet e skulptorëve pjesëmarrës u seleksionuan paraprakisht nga një juri ndërkombëtare, në konkursin elektronik të shpallur nga Bashkia e qytetit. Kanë qenë 80 projekte konkurruese prej të cilave u përzgjedhën vetëm 8.

Ashtu si edhe vitin e kaluar, të gjitha veprat e skulptorëve u gdhendën dhe morën formë në natyrë tek Parku "Rina". Këto vepra kryesisht abstrakte, u realizuan në blloqe gurësh të bardhë, me dimensione të paracaktuara nga vetë artistët. Gjeografia e vendit të origjinës dhe të formimit artistik dhe kulturor të skulptorëve, u konkretizua në këto vepra të artit abstraksionist, të cilat përveç bukurisë estetike mbartin një miksim të historisë, simbolikës, misticizmit dhe traditës së popujve.

Bashkia Korçë me prezencën e Kryetarit të Bashkisë Niko Peleshi, organizoi ceremoninë e marrjes në dorëzim të skulpturave ku morën pjesë personalitete të jetës kulturore në Korçë. Skulptorët hodhën firmën e tyre në pllakën memorial, duke mbetur në kujtesën artistike të qytetit tonë.

Tashmë, 8 skulpturat e edicionit të dytë, u janë shtuar skulpturave të vitit të kaluar duke hijeshuar mjediset e parkut më të frekuentuar të qytetit. Bashkia Korçë është në rrugë të drejtë për të realizuar objektivin e saj kryesor, shndërrimin e Parkut "Rinia" në një galeri natyrore të artit modern.

8 skulpturat e reja, mbartin një miksim të historisë, simbolikës, misticizmit dhe traditës së popujve

Çfarë prezantojnë veprat e artistëve pjesëmarrës



Shen Gjergji

Matthew Simmonds – Britania e Madhe
Realizoi në gur Kishën e vjetër të Shën Gjergjit e cila u prish në vitin 1969, duke evokuar traditën kristiane të lidhur me traditën artistike të qytetërimit tonë.



Përqaqimi

Jorg Plickat – Gjermani
Skulptura e tij do të jetë një krijim vertikal i cili prezanton një lloj skulpture –arkitekturë që evokon lartësitë e katedraleve gotike, por duke e lehtësuar me mjaft finesë peshën e gurit përmes formave gjeometrike.



Dielli

Guliano Giussani – Itali
Vepra e tij titullohet "Dielli". Ajo përfaqëson një krijim, i cili sjell një harmoni estetike mes formës dhe shpirtit, duke gërshetuar format archetipike të mesdheut me strukturat me origjinë aziatike.



Ylberi

Yoshin Ogata – Japoni
Artisti në veprën e tij shpërfaq temën e ujit, i cili është elementi më jetësor i ekzistencës njerëzore.



Meteor

Nagi Fareed – Egjipt
Vepra që propozohet është një formacion gjeometrik me yje, duke kombinuar gurin, i cili është simbol i përjetësisë me çelikun si metaforë e kohëve moderne.



Nyja e dashurisë

Genti Tavanxhiu – Shqipëri
Është pjesëmarrës edhe në simpoziumin e parë të zhvilluar vitin e kaluar në Korçë.
" Il Nodo d'amore" – " Nyja e dashurisë". Ky është koncepti i veprës, ku tema e dashurisë përcillet duke u identifikuar me simbolin e qënies njerëzore dhe të planetit Tokë.



Zogu

Paora Te Ranguaia – Zelanda e Re
Përgjithësisht veprat e tij ju referohen formave tipike të historive e miteve legjendare të popullit të Maorëve.



Thellësi

Tobbel- Gjermani

Kënd lojrash për fëmijët e Lagjes 13 në Ditën Ndërkombëtare Kundër Punës së Fëmijëve

Lulishte dhe kënd lojrash për fëmijët e Lagjes 13 të qytetit, ishte investimi më i fundit i Bashkisë Korçë me ndihmën e UNICEF, në Ditën Ndërkombëtare Kundër Punës së Fëmijëve.

Në këtë ditë, Kryetari i Bashkisë Korçë, Niko Peleshi apeloj për një shoqëri ku fëmijët të jenë të barabartë. Bashkia nëpërmjet programeve të saj do ofrojë mundësinë që këta fëmijë të ndjekin normalisht shkollën, por edhe të argëtohen në kënde lojrash pranë bllokut të tyre të banimit.



Klinika mjekësore "Kristi" mundëson analiza FALAS për 300 të moshuar

300 të moshuar të vetmuar dhe me pamundësi ekonomike, do të kryejnë analiza falas në Klinikën Mjekësore private "Kristi". Kjo është arritur në sajë të një marrëveshje bashkëpunimi të firmosur mes Bashkisë së qytetit dhe Klinikës "Kristi" në qytetin e Korçës, mbi bazën e së cilës, për 10 të shtuna rresht, 30 të moshuar të vetmuar dhe me mundësi të kufizuara financiare, do të kryejnë analiza mjekësore falas. Klinika "Kristi", me një përvojë 10 vjeçare në qytetin tonë, vjen kësaj here për bashkëqytetarët e vet me një fytyrë më humane, duke u bërë pjesë e programeve sociale të Bashkisë së qytetit.



Nëpërmjet programeve sociale të përgatitura, Bashkia Korçë synon të kontribuojë në zbutjen e plagëve sociale të shoqërisë sonë, duke e bërë atë më humane.

Vendos foto

Dita Ndërkombëtare e Mjedisit Qytetarët i bashkohen nismës së Bashkisë Korçë

"Për një Korçë më të pastër" ishte edhe për vitin 2009, slogani i të gjithë fushatës sensibilizuese të Bashkisë Korçë, e cila më 5 –Qershor, në Ditën Ndërkombëtare të Mjedisit, përfshiu në aksione konkrete banorë të Korçës, vullnetarë të Shoqërisë Civile, ndërmarrjen e kontraktuar për pastrimin e qytetit "Korsel", punonjës të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike e punonjës të Bashkisë Korçë.

Mjaft inkurajuese ishte edhe përfshirja e qytetarëve korçarë, duke dhënë mesazhin se të gjithë duhet të kujdesemi e të investojmë së bashku për ambientin, pasi ky është një investim për cilësinë e jetës, për fëmijët, për të ardhmen.

Kryetari i Bashkisë Niko Peleshi, i pranishëm në disa zona të qytetit, ka hedhur mesazhin se shpirti i komunitetit ka akoma nevojë të përmirësohet dhe se kujdesi për sipërfaqet publike dhe territoret e përbashkëta duhet të jetë i njëjtë, ashtu siç kujdesemi për shtëpitë tona.

Qytetar!

Ruaj të pastër mjedisin e qytetit tënd!





me PROGRAMET TONA...



Festojmë së bashku 1-Qershorin

Qendra e Parkut "Rinia" në ditën e 1 - Qershorit u shndërrua në arenën e festës së fëmijëve, e cila u kthye për ta dhe për prindërit në një festë plot ngjyra, muzikë dhe argëtime, në një park ku fëmijët jo vetëm argëtohen dhe mësojnë, por edhe apelojnë për më shumë të drejta e më shumë festa.

Një vizitë, Kryebashkiaku Niko Peleshi u rezervoji edhe fëmijëve të kopshtit rom "Lulet e vogla", të cilëve u ka dhuruar një kompjuter dhe një magnetofon me kontributin e organizatës Terre des Hommes, duke dhënë mesazhin e rritjes së brezit të ri pranë teknologjive të informacionit.



Java e Kinemasë Verore

Filmat më të preferuar për fëmijët shihen në çdo lagje. Përgjatë një jave, në datat 15 deri 22 qershor, në ambiente të hapura, në çdo lagje të qytetit, pranë

lulishteve e këndeve të lojrave, fëmijët u argëtojnë duke ndjekur filmat më të preferuar për ta, të përzgjedhura me kujdes nga videotekat e qytetit.



Teatri shëtitës i kopshteve

Fëmijët argëtohen duke zhvilluar talentin e tyre "Teatri shëtitës i kopshteve", projekti më i ri i Bashkisë, përfshiu 12 kopshtet e qytetit të Korçës, fëmijët e të cilëve interpretuan si aktorë të vërtetë, fabulat e përzgjedhura nga mësueset e tyre.

Juria vlerësoi si shfaqjen më të bukur atë të Kopshtit të Lagjes Nr. 9, të titulluar "Duduqi".

Më pas 5 kopshtet shëtitës, interpretuan fabulat për bashkëmoshatarët e tyre të kopshteve të tjerë.

Kampet Verore për fëmijët

-Eksperiencia të reja

-Miq të rinj

-Argëtim

Kampi Veror për fëmijët zhvilloi aktivitetin e tij në Parku "Rinia".

Në të morën pjesë 120 fëmijë të moshës nga 6 deri 12 vjeç prej të cilëve 60 fëmijë në nevojë, që vijnë nga familje me probleme social-ekonomike.

Gjatë 10 ditëve të qëndrimit në Kamp, fëmijët shkuan në kinema, teatër dhe ekskursion.



Panairi i Punës 2009 ... ofrojmë mundësi

Për të tretin vit, Panairi i Punës 2009, çeli dyert e tij në Korçë, duke u bërë vendtakimi mes punëkërkuësve dhe punëmarrësve. Për këtë vit, 17 firma e kompani private si dhe institucione shtetërore, intervistuan mbi 450 punëkërkuës, kryesisht studentë dhe të diplomuar në arsimin e lartë, por edhe të tjerë punëkërkuës me arsim të mesëm, duke iu krijuar atyre mundësinë të përballen në mënyrë të ndershme me ofertat e tregut.

Pjesë e këtij panairi, është edhe projekti i Bashkisë Korçë për punësimin sezonal të studentëve, kërkesa e të cilëve nga viti në vit sa vjen dhe rritet. Vetëm për verën e 2009-ës, në sektorë të ndryshëm



të institucionit të Bashkisë, e fituan të drejtën për tu punësuar sezonalisht 32 studentë.

Edhe për këtë vit, Panairi i Punës kishte mbështetjen e USAID.

Ai ishte një bashkëpunim i Bashkisë Korçë, Dhomës së Tregëtisë dhe Industrisë, Universitetit "F.Noli, Fondacionit "Tabita" dhe Qendrës për Zhvillim Komunitar.

Pjesëmarrja e Shoqatës së Invalidëve i dha një tjetër fytyrë këtij panairi. Persona me aftësi të kufizuar kërkuar të gjenin një mundësi në këtë panair, duke hedhur mesazhin se sejcili është i aftë të kontribuojë për veten dhe për shoqërinë, duke mos mbetur thjesht një përfitues pasiv.

Shkolla verore e fotografisë

Bashkia e qytetit të Korçës organizoi për të dytin vit, Shkollën Verore të Fotografisë, nën drejtimin e fotografit profesionist Eljano Kalemi

Nxënësit, punuan me tema krejtësisht të lira, duke mësuar teknika të ndryshme të fotografimit dhe të përpunimit të fotos.



Në muajin shtator, mbi 40 fotografi të përzgjedhura, u ekspozuan për amatorët e fotografisë dhe artdashësit në ambientet e Qendrës Kulturorë "V.Mio".

... sepse ne jemi KORÇA E KULTURËS



Netët Korçare të Poezisë

Lirika e Rusit përcillet me emocion nga Mirush Kabashi

Më 15 qershor 2009, Netët Korçare të Poezisë hynë në edicionin e 11-të të tyre. Aktiviteti i përvitshëm artistik kushtuar vetëm poezisë, solli në Korçë 25 poetë shqiptarë dhe 18 poetë të huaj, poetë të afirmuar, por edhe të rinjtë nga trevat shqipfolëse, Shqipëri, Kosovë e Maqedoni, por edhe poetë të tjerë nga Bullgaria, Mali i Zi, Turqia, Greqia e Italia.

Nata e parë e këtij manifestimi poetik, është çelur nga aktori i madh i skenës shqiptare, i ftuari i nderit i këtij edicioni Mirush Kabashi, i cili ka ndezur atmosferën duke përcjellë me mjeshtëri vargje nga lirikat e poetit korçar Skënder Rusi.

Netët Korçare të Poezisë 2009, i dhanë poetit Ylber Merdani kurorën për krijimin më të mirë.

Ditën e dytë, në sallën shkencore të bibliotekës, në një tryezë të rumbullakët poetët diskutuan rreth temës: "Ku po e çojmë poezinë".

Pallati i grave, komedi në Teatrin "Çajupi"

Komedia trajton problemet sociale të shoqërisë shqiptare, veset, të cilat jo rrallë i bëjnë burrat të dhunshëm, qesharakë e të vështirë. Kësaj here të gjitha këto janë veshur në petkun e personazheve gra.

Komedia kalon në situata komike e shumë të këndshme për publikun. Ajo gërshetohet me këngët e serenatave të interpretuara nga Laxarela e Gjergji Mani.

Komedia e shkruar nga Erand Sojli, me skenografi nga Roland Karanxha e muzikë nga Adrian Jorgji, u vu në skenë nga Guri Koço.

Ajo u interpretua nga aktorët profesionistë të Teatrit të Korçës Arben Dervishi, Julja Ilirjani, Zamira Kota, Petrika e Klaudeta Riza, Alban Prodan.

Ekspozita vetjake e piktorit akademik Jetullah Haliti

Piktori akademik nga Kosova Jetullah Haliti, në datën 15 korrik, çeli ekspozitën vetjake me 40 punime në teknikën e vajit, grafisë si dhe disa fotografi.

Ekspozita e tij krejt e veçantë në stil, pas rrugëtimit në qytetet e Durrësit, Elbasanit e Pogradecit u çel edhe në qytetin e Korçës.

Autori është themelues i Profondizmit, i cili është një stil i ri që përfaqëson në pikturë rrymën postmoderne. Piktori Haliti është autor i 80 ekspozitave brenda e jashtë vendit dhe fitues i shumë çmimeve ndërkombëtare.

Maratona e Muzikës Popullore

Maratona e Muzikës Popullore, pas suksesit në qytetin tonë vitin e kaluar, erdhi edhe këtë vit si spektakli veror më i rëndësishëm i muzikës popullore e qytetare në shkallë vendi. Këtë e tregoi më së miri numri i madh i qytetarëve në sheshin para Katedrales ku u zhvillua ky spektakël, në të cilin të gjithë kanë kënduar e kërcyer me ritmet popullore më të bukura të këtij sezoni.

Në këtë mënyrë Bashkia e Korçës nëpërmjet financimit të këtij spektakli, iu dhuroi qytetarëve të vet një mbrëmje të bukur, ku arti bashkohet me shijet artistike të qytetarëve pa dallim moshe.

Çmimi i dytë për Bandën e Korçës në Festivalin e Sarandës

Në datat 7 deri 11 korrik, Banda Muzikore e Korçës nën drejtimin e dirigjentit dhe muzikologut Pandi Bello, mori pjesë në Festivalin e 4-t të Bandave Muzikore që zhvillohet çdo vit në qytetin e Sarandës.

Mes 16 formacioneve nga vendi e grupeve të huaja pjesëmarrëse në këtë festival, juria e kryesuar nga kompozitori i mirënjohur shqiptar Thoma Gaqi, vlerësoi Bandën Muzikore të Korçës me çmimin e dytë, ndërkohë që çmimi i parë i kaloi Bandës së qytetit të Shkodrës.

Zhvillohet SONDAZHI i Performancës së Bashkisë Korçë


Bashkia orienton programet në përputhje nevojat e qytetarëve

Gjatë muajit maj, Bashkia Korçë me asistencën e organizatës "Partnerët Shqipëri", zhvilluan Sondazhin e Performancës së Bashkisë Korçë gjatë viteve 2007-2008.

Sipas një grafiku të përcaktuar, sondazhi është shtrirë në të gjitha lagjet e qytetit duke u shpërndarë në mënyrë proporcionale sipas numrit të popullsisë.

Janë pyetur 400 banorë të Korçës, të cilët kanë shprehur opinionin e tyre në lidhje me çështje të tilla si: situata aktuale e infrastrukturës rrugore, pastërtia në qytet, mjedisi dhe sipërfaqet e gjelbra, shërbimi i transportit urban dhe taksi, aktivitetet kulturore, pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje, burimet e informacionit dhe cilësia e tyre.

Rezultatet e këtij sondazhi janë përpunuar në mënyrë të hollësishme dhe mjaft profesionale nga "Partnerët Shqipëri" dhe mbi bazën e opinionëve dhe të nevojave të qytetarëve, Bashkia e qytetit po punon duke orientuar programet dhe politikat e saj për vitet në vazhdim.



Ne cilin drejtim mendoni se ka punuar me mire Bashkia Korçe gjatë vitit 2009

- Aktivitete kulturore
- Gjelberim
- Infrastruktura
- Projekte sociale

Votoni

Shihni rezultatet e sondazhit

Fjalën e ke ti!

Jepni opinionin tuaj duke klikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë www.bashkiakorçe.gov.al

Meritojnë falenderimin tonë...



4 studiot pjesëmarrëse në Konkursin Ndërkombëtar për Masterplanin e qendrës së Korçës.

The studios participating to The International Masterplan Competition.



8 skulptorët pjesëmarrës në Koloninë Ndërkombëtare të Skulpturës "Korça 2009".

The sculptors participating to the Internationale Colony of Sculpture "Korça 2009"



Kopshtet e qytetit dhe Drejtorinë Arsimore Rajonale për bashkëpunimin në realizimin e projektit: "Teatri shëtitës i kopshteve".

The kindergartens of Korça and The Regional Education Directory for their collaboration in the project "The traveling kindergarten Theater".



Qytetarët e Korçës por edhe vizitorët vendas dhe të huaj që u bënë pjesë e festave dhe eventeve të organizuara nga Bashkia gjatë stinës së verës.

The citizens of Korça, the local and foreign visitors who become part of the events and celebrations organized by The Municipality of Korça in summer.



Fëmijë të veshur karnaval



Përgatitën:

Ana Qeramixhi
Benila Tërova
Sofjola Kotelli

Ndihmuan:

Stafi i Bashkisë
Korçë
Ndërmarrja e
Shërbimeve Publike
Pallati i Kulturës
"V.Mio"
Teatri "A.Z.Çajupi"

Për një qytet ku bashkëjeton tradita me modernen, ku të rinjtë realizojnë aspiratat e tyre për shkollim dhe punësim, ku të moshuarit jetojnë ditë të bardha, një qytet që ka gjithmonë një dorë të zgjatur për të nxjerrë nga vështirësia dhe ku problemi yt gjen një zgjidhje. Pas një kthese ecim me vrull në një drejtim të ri për të kapur kohën e humbur dhe për të dalë në krye siç i ka hije Korçës. Ky është identiteti ynë i ri.

Fotot nga:

Ana Qeramixhi
Vaskë Niço (Billet)
Studio "Xhimi"
Studio "Alvin"

Design:

tninqpoint®



Mbështesni "Qyteti im"

Për më tepër informacion:

Tel: 082 245755

e-mail: qyteti.im@bashkiakorke.gov.al

bashkiko@albmail.com

www.bashkiakorke.gov.al